

**VENDIM**  
**Nr.443, datë 27.4.2009**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 370, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE**  
**TË NËPUNËSVE TË ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008, “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.370, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1.1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Nivelet e pagave për funksionet e mëposhtme të jenë:

- |                                                                                                                                                                      |                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|
| a) Prefekt i qarkut të Tiranës,                                                                                                                                      | 115 000 lekë;  |
| b) Prefekt i qarqeve të tjera,                                                                                                                                       | 107 000 lekë;  |
| c) Nënprefekt në nënprefekturat e Kavajës, Lushnjës dhe Sarandës,                                                                                                    | 92 000 lekë;   |
| ç) Nënprefekt në nënprefekturat e Krujës, Pogradecit, Librazhdit, Tepelenës, Përmetit, Matit, Pukës, Tropojës dhe Skraparit,                                         | 85 000 lekë;   |
| d) Nënprefekt në nënprefekturat e Malësisë së Madhe, Bulqizës, Peqinit, Gramshit, Devollit, Mallakastrës, Hasit, Kuçovës, Mirditës, Delvinës, Kurbinit dhe Kolonjës, | 79 500 lekë;   |
| dh) Këshilltar i prefektit të Tiranës,                                                                                                                               | 62 000 lekë;   |
| e) Zëdhënës i prefektit të Tiranës,                                                                                                                                  | 52 000 lekë.”. |

1.2. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

1.3. Në pikën 3, vlera “11 000 lekë” zëvendësohet me “12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e politikës së pagave, miratuar për vitin 2009.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

|  |  |                    |
|--|--|--------------------|
|  |  | <b>Paga mujore</b> |
|--|--|--------------------|

| Emërtimi                                                                | Kategoria | Paga individuale        |                                             |                                  | Shtesa e pozicionit            |
|-------------------------------------------------------------------------|-----------|-------------------------|---------------------------------------------|----------------------------------|--------------------------------|
|                                                                         |           | 1                       | 2                                           | 3                                | 4                              |
|                                                                         |           | Paga e grupit (PG) lekë | Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) përqindje | Shtesa për kualifikim (SHK) lekë | Shtesa për pozicion (SHP) lekë |
| Sekretar i Përgjithshëm në prefekturë                                   | III-a     | 12 000                  | 2%                                          |                                  | 69 000                         |
| Sekretar i Përgjithshëm në nënprefekturat Kavajë, Lushnjë dhe Sarandë   | III-a/1   | 12 000                  | 2%                                          |                                  | 60 000                         |
| Përgjegjës sektori në prefekturë                                        | III-b     | 12 000                  | 2%                                          |                                  | 52 000                         |
|                                                                         | IV-a      | 12 000                  | 2%                                          |                                  | 41 000                         |
| Përgjegjës zyre në prefekturë<br>Përgjegjës zyre në nënprefekturë       | IV-a      | 12 000                  | 2%                                          |                                  | 41 000                         |
| Përgjegjës sektori në nënprefekturë<br>Inspektorë auditit në prefekturë | IV-a      | 12 000                  | 2%                                          |                                  | 41 000                         |
| Specialist në prefekturë                                                | IV-b      | 12 000                  | 2%                                          |                                  | 31 000                         |
|                                                                         | IV-c      | 12 000                  | 2%                                          |                                  | 23 000                         |
| Specialist në nënprefekturë                                             | IV-c      | 12 000                  | 2%                                          |                                  | 23 000                         |
| Sekretar                                                                | IV-c      | 12 000                  | 2%                                          |                                  | 23 000                         |